




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-020-15114 data 06.05 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kritetret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurat e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.

- I. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020, janë:
 1. Agim Kastrati
 2. Mehdi Ademi
 3. Behxhet Binaku
 4. Fluida Nika
 5. Hazir Elshani
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për kërkesat për subvencionim përmes thirrjes publike për aplikim për vitin 2020, duke u bazuar në Rrregulloren 12.Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve si dhe në Rregullorën MF-NR 04/2017 Mbi Kritetret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve
- III. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020, punën e tyre duhet ta kryejn me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

IV. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020, ka për obligim që të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha kërkesat pranë kësaj drejtorie në afatin kohor të përcaktuar me Rregullorës 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe në të njejtën kohë të njoftoj me shkrim Kryetarin e Komunes dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimin e kërkesave.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Vendimi iu dwrgohet:

- Zyrës së Kryetarit,
- Zyrës së Personelit
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit



KRYETARI KOMUNËS
Ramir Lladrovci